



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI SHTETËROR PËR HARTIMIN E FONDIT TË PYETJEVE PËR PROVIMIN SHTETËROR
TË LICENCIMIT TË PSIKOLOGËVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR NDËRTIMIN E FONDIT TË ARTIKUJVE
TESTUES PËR PROVIMIN E SHTETIT PËR LICENCIM NË FUSHËN E
PSIKOLOGJISË**

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

1. UDHËZIM I PËRGJITHSHËM PËR STRUKTURËN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT	3
2. UDHËZIM I VEÇANTË	4
3. TEMATIKA SIPAS FUSHAVE FORMUESE TË PSIKOLOGJISË NË PROGRAMET E NIVELIT BACHELOR	6
4. TEMATIKA SIPAS PROFILVE FORMUESE TË PSIKOLOGJISË NË PROGRAMET E NIVELIT MASTER	7
5. STRUKTURA E PROPOZUAR PËR PROGRAMIN E PROVIMIT TË SHTETIT NË FUSHËN E PSIKOLOGJISË	9

1. UDHËZIM I PËRGJITHSHËM PËR STRUKTURËN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT

Dokumenti në vijim quhet “Programi i provimit të licencimit në psikologji”. Ky dokument do të shërbejë si bazë për ndërtimin e fondit të artikujve¹ (pyetjeve/kërkesave), prej të cilit do të ndërtohen testet për të vlerësuar aplikantët për licencim në fushën e psikologjisë.

Ky program mund të shërbejë gjithashtu edhe si bazë për të ndërtuar një program orientues për përgatitjen e aplikantëve për testimin, por kjo gjë nuk është qëllimi i tij. Madje, në një këndvështrim më të gjerë, programin shikohet si një dokument i vlefshëm për t’u konsideruar edhe nga universitetet e vendit të cilat punojnë për formimin e psikologëve.

Ky program është ndërtuar nga komisioni i ngritur në zbatim të Rregullores “Për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 365, datë 28.12.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Pas shqyrtimit paraprak, komisioni arriti në përfundimin që provimi i licensimit duhet të ritejtojë formimin akademik që studenti ka realizuar gjatë shkollimit të tij. Studimet në fushën e psikologjisë në Shqipëri ofrohen nga një numër jo i vogël universitetesh dhe, megjithë fondin e përbashkët të informacionit që ofrohet, ato kanë edhe diferenca të caktuara që lidhen më së shumti me mundësitë që universitetet kanë pasur, por edhe me lirinë akademike për të ofruar programet që mendohet se e realizojnë më mirë formimin në këtë profesion. Në këto kushte komisioni u përball me çështjen e ndërtimit të një fondi i cili u mundëson studentëve të diplomuar në psikologji të mund të dëshmojnë formimin e tyre pavarësisht se në cilin universitet kanë studiuar. Komisioni është kujdesur të zbulojë fondin e përbashkët të formimit në psikologji duke lënë mënjanë aspekte të cilat përbëjnë theksime ose mungesa të caktuara të universiteteve të veçanta. Për këto aspekte të veçanta të formimit të tyre universitar aplikantët janë

¹ Këtej e në vijim termi “artikull, artikuj” do të përdoret për të shënuar pyetjet ose kërkesat që përmban një test me të cilin maten arritjet mësimore.

testuar dhe vlerësuar gjatë shkollimit të tyre, ndërsa fondi i përbashkët do të jetë objekt i procesit të testimit për licencim, i cili është një proces që teston formimin.

Komisioni bëri përpjekjet e veta për të kapërcyer mungesat e informacionit në fushën e studimeve të psikologjisë në Shqipëri. Për këtë ai u mbështet në punën e anëtarëve të tij, të cilët kryen një skanim të objektivave dhe kompetencave kryesore të ofruara në të gjitha universitetet. Në këtë kuadër, për të identifikuar fondin e përbashkët të materialit të studiuar gjatë studimeve në universitete të ndryshme të vendit, komisioni mblodhi të gjitha planet mësimore të studimeve bachelor dhe master në universitetet shqiptare, publike e jopublike me qëllim që programi final të reflektonte thellësisht mësimdhënien universitare në psikologji në Shqipëri.

Ky fond i përbashkët, do të jetë baza për të krijuar artikuj për testimin e aplikantëve në provimin e licencimit. Autorët e këtij programi testimi do të punojnë për hartimin e fondit të artikujve me këto dokumente kryesore: planet mësimore për studime psikologjike universitare, sylabuset e lëndëve të psikologjisë, si dhe tekstet mësimore që përdoren në këto programe.

Metodologjia e punës së komisionit bazohet në studimin e materialit dokumentar të përmendur më sipër, në diskutimet ndërmjet anëtarëve të komisionit, në konsultat me pedagogë të lëndëve të psikologjisë nëpër universitetet e vendit dhe me përfaqësues të Urdhrit të Psikologëve, në trajnime për rritjen e aftësive për ndërtim instrumentesh matëse, si dhe do të pilotojë disa kampione të fondit të ndërtuar. Më pas, do të finalizohet edhe fondi i plotë i artikujve (pyetjeve / kërkesave) për provimin e licencimit me synimin që të jetë një testim objektiv i të gjithë të diplomuarve në psikologji pavarësisht nga universiteti ku ata janë diplomuar.

2. UDHËZIM I VEÇANTË

Fondi i pyetjeve/kërkesave për testimin për licencim në fushën e psikologjisë do të ndërtohet në bazë të objektivave të formuluar në sylabuset e lëndëve të psikologjisë.

Testimi për licencim në fushën e psikologjisë do të synojë të vlerësojë njohuritë dhe shkathtësitë aplikative të të diplomuarve në psikologji, bazuar në planet, sylabuset dhe tekstet më të shënuara për formim në psikologji.

Karakteri i artikujve (pyetjeve/kërkesave) do të priret t'i largohet riprodhimit mekanik të informacionit dhe do të kërkojë dhe vlerësojë përdorimin e informacionit. Ato do të jenë të ndërtuara në nivele nga pikëpamja e vështirësisë për të mundësuar që të diplomuarit të mund të shprehin aftësitë e tyre përgjatë atyre niveleve.

Fondi për testin e licencimit do të përbëhet nga artikuj (pyetje/kërkesa) të cilat i japin aplikantit mundësi të dëshmojë shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive dhe të shkathtësive për përdorimin e tyre.

Karakteristikë dalluese e testit të provimit të licencimit do të jetë mundësia e krijuar që aplikantët të mund të përballen me artikuj të tre niveleve: pyetje/kërkesa me nivel relativisht të ulët vështirësie (identifikim e përshkrim), pyetje/kërkesa me nivel relativisht mesatar vështirësie (shpjegim dhe analizë) dhe pyetje/kërkesa me nivel relativisht të lartë vështirësie (vlerësim dhe vendimmarrje). Tabela në vijim shpreh konvertimin në % të fondit sipas nivelit të vështirësisë.

NR.	Niveli i ulët	Niveli mesatar	Niveli lartë
1.	Identifikim e përshkrim	Shpjegim dhe analizë	Vlerësim dhe vendimmarrje
2.	40%	40%	20%

3. TEMATIKA SIPAS FUSHAVE FORMUESE TË PSIKOLOGJISË NË PROGRAMET E NIVELIT BACHELOR

Kjo pjesë e programit të provimit zë 70% të të gjithë fondit të pyetjeve dhe përbëhet nga 5 fusha kryesore, si më poshtë vijon.

1. Fusha e biopsikologjisë. (Kjo fushë zë 10% të 70% të fondit të pyetjeve).

1. Sistemi nervor dhe endokrin dhe bashkëveprimi i trashëgimisë me mjedisin.
2. Zhvillimi para lindjes.
3. Proceset ndijore.
4. Drogat psikoaktive dhe efektet e tyre.
5. Stresi, fiziologjia e tij dhe fazat e përjetimit/përballimit.
6. Gjumi, tipet, teoritë, çrregullimet e gjumit dhe ëndrrat.
7. Gjenetika e sjelljes.

2. Fusha e zhvillimit. (Kjo fushë zë 25% të 70% të fondit të pyetjeve).

1. Teoria e Frojdit mbi zhvillimin.
2. Teoria e Piazhësë mbi zhvillimin.
3. Teoria e Eriksonit dhe Kohlbergut mbi zhvillimin.
4. Bazat biologjike dhe sociale të zhvillimit njerëzor.
5. Karakteristikat e zhvillimit fizik, kognitiv, moral e social në foshnjëri dhe fëmijëri.
6. Karakteristikat e zhvillimit fizik, kognitiv, moral e social në adoleshencë dhe në moshën e rritur.
7. Faktorë me ndikim mbi zhvillimin sipas grupmoshave.

3. Fusha e kognicionit. (Kjo fushë zë 20% të 70% të fondit të pyetjeve).

1. Organizimi perceptiv, proceset dhe teoritë.
2. Vëmendja dhe procesimi i informacionit.
3. Kujtesa, llojet, harresa.
4. Gjuha dhe teoritë mbi zhvillimin gjuhësor.
5. Inteligjenca, teoritë dhe matja e saj.
6. Teoritë mbi procesin e të nxënës.
7. Zgjidhja e problemeve dhe marrja e vendimeve.

4. Fusha e personalitetit. (Kjo fushë zë 25% të 70% të fondit të pyetjeve).

1. Teoritë psikanalitike, bihevjoriste, kognitiviste dhe humaniste mbi formimin e personalitetit.
2. Teoritë psikanalitike, bihevjoriste, kognitiviste dhe humaniste mbi formimin e psikopatologjisë.
3. Teoritë dhe taksonomia mbi tiparet e dallueshme dhe të qëndrueshme të personalitetit.
4. Vlerësimi dhe matjet e personalitetit.
5. Përshtatja: përballimi, tipologjitë e personalitetit.
6. Grupet kryesore të çrregullimeve psikologjike (DSM).
7. Qasjet kryesore të trajtimit të psikopatologjive dhe teknikat.

5. Fusha e psikologjisë sociale/komunitare. (Kjo fushë zë 20% të 70% të fondit të pyetjeve).

1. Uni dhe perceptimi social.

2. Atribuimi: funksioni, burimi dhe gabimet atributive.
3. Qëndrimet, formimi dhe ndryshimi i tyre.
4. Ndikimi social dhe proceset grupale.
5. Pushteti social dhe lidhshipi.
6. Proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore në organizatë.
7. Struktura dhe kultura organizacionale.

4. TEMATIKA SIPAS PROFILVE FORMUESE TË PSIKOLOGJISË NË PROGRAMET E NIVELIT MASTER

Profilat e studimeve të nivelit master në psikologji janë 5 dhe janë renditur më poshtë:

1. Profili i psikologjisë klinike. (Ky profil do të përmbajë 30% të fondit të përgjithshëm të 1500 pyetjeve).

1. Psikopatologjitë e zhvillimit (DSM): kategoritë kryesore të diagnostikimit.
2. Psikodiagnostika: vlerësimi dhe testimi psikologjik.
3. Kontributet teorike të shkollave të këshillimit dhe të psikoterapisë.
4. Kontributet teknike të shkollave të këshillimit dhe të psikoterapisë.
5. Çështje të etikës profesionale në vlerësim, diagnostikim e trajtim klinik.
6. Metodatat e kërkimit shkencor në fushën e psikologjisë klinike.

2. Profili i psikologjisë së edukimit/shkollore. (Ky profil do të përmbajë 30% të fondit të përgjithshëm të 1500 pyetjeve).

1. Rolet profesionale të psikologut shkollor në marrëdhëniet me mësuesit, prindërit, nxënësit dhe agjencitë komunitare.
2. Vlerësimi dhe trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.
3. Vlerësimi i ecurisë mësimore dhe i sjelljes joadaptive të nxënësve.
4. Etika profesionale e psikologut shkollor/edukimit.
5. Këshillimi dhe konsultimi psikologjik në shkollë.
6. Metodatat e kërkimit shkencor në fushën e psikologjisë së edukimit.

3. Profili i psikologjisë organizacionale. (Ky profil do të përmbajë 30% të fondit të përgjithshëm të 1500 pyetjeve).

1. Praktikat e vlerësimit të punonjësve, nevojave të tyre për trajnim dhe zhvillim profesional.
2. Psikologjia në praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore (rekrutimi, përzgjedhja, vendosja në pozicionin e përshtatshëm, etj.)
3. Praktikat e drejtimit dhe menaxhimit të punonjësve (lidhshipi)
4. Etika në organizatë.
5. Orientimi në karrierë dhe zhvillimi i tregut të punës.
6. Vlerësimi i nevojave, preferencave dhe kënaqësisë së konsumatorëve.
7. Metodatat e kërkimit shkencor në fushën e psikologjisë organizacionale.

4. Profili i psikologjisë ligjore. (Ky profil do të përmbajë 30% të fondit të përgjithshëm të 1500 pyetjeve).

1. Psikologjia e sjelljes deviante dhe kriminale.
2. Dëshmitari okular.

3. Profilimi psikologjik.
4. Sjellja agresive dhe viktimizimi.
5. Vlerësimi psikologjik në kontekst ligjor.
6. Etika, ligji dhe çështjet profesionale në psikologjinë ligjore.
7. Metodatat e kërkimit shkencor në fushën e psikologjisë ligjore.

5. **Profili i psikologjisë sociale/komunitare.** (Ky profil do të përmbajë 30% të fondit të përgjithshëm të 1500 pyetjeve).

1. Grupet sociale: ndikimi social, lehtësimi social, simptomat dhe pasojat e unanimitetit.
2. Marrëdhëniet personale, sjellja prosociale dhe antisociale: fazat e krijimit të marrëdhënieve ndërpersonale, procesi i ndihmës, agresiviteti etj.
3. Paragjykimet: burimet e paragjytimeve, diskriminimi dhe stereotipet.
4. Parandalimi i rreziqeve dhe promovimi i mirëqenies në komunitet.
5. Planifikimi i ndërhyrjes në komunitet.
6. Çështje etike të punës me grupe: konfidencialiteti, privatësia, miratimi i informuar, etika në kërkimin shkencor etj.
7. Metodatat e kërkimit shkencor në fushën e psikologjisë sociale/komunitare.

5. STRUKTURA E PROPOZUAR PËR PROGRAMIN E PROVIMIT TË SHTETIT NË FUSHËN E PSIKOLOGJISË

NR.	Fushat e bachelorit dhe profilet e masterave	Numri i artikujve (pyetjeve/kërkesave)	Nivelet e vështirësisë			Ponderimi (% e totalit)	Koment
			1	2	3		
A. Programi i formimit në ciklin e parë							
1.	Biopsikologjia [10%]	105 [42+42+21]	1 [40%]	2 [40%]	3 [20%]	70% e 1500	Përfshihet kërkimi shkencor bazik (rreth 10% e totalit të profilit)
2.	Zhvillimi [25%]	262 [105+105+52]	1 [40%]	2 [40%]	3 [20%]		
3.	Kognicioni [20%]	210 [84+84+42]	1 [40%]	2 [40%]	3 [20%]		
4.	Personaliteti [25%]	263 [105+105+53]	1 [40%]	2 [40%]	3 [20%]		
5.	Psikologjia sociale [20%]	210 [84+84+42]	1 [40%]	2 [40%]	3 [20%]		
Σ Bch.		1050				1050	
B. Programi i formimit në profilet e ciklit të dytë							
1.	Klinik	450 [180+180+90]	1 [40%]	2 [40%]	3 [20%]	30% e 1500	Përfshihet kërkimi shkencor (20% e totalit të profilit)
2.	Edukimi/Shkollor	450 [180+180+90]	1 [40%]	2 [40%]	3 [20%]		
3.	Organizacional	450 [180+180+90]	1 [40%]	2 [40%]	3 [20%]		
4.	Ligjor	450 [180+180+90]	1 [40%]	2 [40%]	3 [20%]		
5.	Social/komunitar	450 [180+180+90]	1 [40%]	2 [40%]	3 [20%]		
Σ për profil.		450				450	
Σ Bch + Σ MSc.		1050 + 450=1500				1500	

Shënim:

- Literatura për studimin për provimin e shtetit për licencimin e psikologëve do të jetë po ajo me të cilën studentët kanë kryer dy ciklet e studimit.
- Organizimi i fazimit të procesit si edhe i radhës së testimit kryhen nga QSHA.